Proyecto PID2023-149252NB-I00 financiado por:
MINISTERIO DE CIENCIA, INNOVACIÓN Y UNIVERSIDADES
Cofinanciado por la Unión Europea
AGENCIA ESTATAL DE INVESTIGACIÓN

I intervistuari: Rudolf Marku (1952).
Intervistues[i]/ja: Emilio J. Gallardo-Saborido dhe Brikena Smajli.
Vendi dhe data e intervistës: pyetësor i dërguar me postë elektronike në shkurt 2026.

Projekti kërkimor **ELASOC II** (https://elasoc.csic.es/) bashkon studiues nga vende të ndryshme europiane për të studiuar procesin e ndërkombëtarizimit të letërsisë latinoamerikane në kontekstin gjeografik dhe politik të vendeve socialiste europiane gjatë Luftës së Ftohtë, si dhe rolin që ka luajtur letërsia latinoamerikane në kuadrin e Luftës së Ftohtë kulturore.

Një nga rezultatet e këtij projekti është realizimi i intervistave me aktorë kulturorë të rëndësishëm brenda këtyre konteksteve historike dhe, në mënyrë të veçantë, me ata individë që kanë luajtur një rol në përhapjen e letërsisë hispanoamerikane.

1. RRUGËTIMI PROFESIONAL

Nga punimet e mëparshme (shih referencat), kemi pasur mundësi të njihemi me profilin tuaj biografik dhe atë profesional, megjithatë, do të dëshironim të thellonim disa aspekte të tij.

1.1. A mund të na flisni për periudhën tuaj të formimit në Universitetin e Tiranës («Rudolf», s. f.; ExLibris, 2020)?

Kam ndjekur studimet Universitare në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në vitet 1969-1973, në Degën Letërsi-Linguistikë. Periudhë që përkon dhe me botimet e mia të para në shtypin e kohës (*Zëri i Rinis*ë' dhe *Drita*). Periudha e studimeve dhe botimeve të mia të para është periudha e vetme e një farë «liberalizmi», - natyrisht, në standardin shqiptar, e lejuar më tepër si një test, një lloj sprove, e vetë Partisë komuniste në pushtet (vitet 1970-1972). Ironikisht, menjëherë pas këtyre viteve, duke filluar nga viti 1973, Shqipëria kalon në një izolim të mëtejshëm dhe në një kontroll të paparë paranoiak, sidomos në fushën e kulturës dhe të krijimtarisë artistike. Nuk duhet harruar se asaj kohe ndjehej dhe mbërritja e dallgëve të «cunamit» kinez të revolucionit kulturor dhe në brigjet shqiptare të Adriatikut.

Për temë diplome në vitin e fundit të studimeve pata zgjedhur studimin e poemës së një shkrimtari klasicist shqiptar, «Andrra e jetës» të Ndre Mjedjes. I gjithë studimi im ka qenë përpjekja për të argumentuar ndikimin nga drama *La vida es sueño* [Jeta asht andërr] të Pedro Calderon de la Barca-s - të cilën e kisha lexuar në italisht - në këtë poemë të Mjedjes. Ky i fundit, një poet dhe prift jezuit, kishte studiuar në Spanjë, në vitet e rinisë së vet dhe ai kishte deklaruar disa herë njohjen dhe admirimin për dramaturgjinë e Pedro Calderonit. Argumentet e mia u quajtën të gabuara, sepse nuk mund të pranohej që një shkrimtar klasik shqiptar të qe ndikuar nga një autor i huaj. Por kjo nuk e pengoi jurinë e profesorëve që ta vlerësonin punimin tim me notën maksimale.

Esta publicación es resultado del proyecto *Escritores latinoamericanos en los países socialistas europeos durante la Guerra Fría. Fase II* (ELASOC II, PID2023-149252NB-I00) financiado por MICIU/AEI/10.13039/501100011033 y por FEDER, UE.

Proyecto PID2023-149252NB-I00 financiado por:
MINISTERIO DE CIENCIA, INNOVACIÓN Y UNIVERSIDADES
Cofinanciado por la Unión Europea
AGENCIA ESTATAL DE INVESTIGACIÓN

1.2. Kemi mundur të mësojmë se nga viti 1987 deri në vitin 1990 keni punuar si redaktor i poezisë dhe përkthimeve në gazetën *Drita* (Shqiptarja.com, 2013; *ExLibris*, 2020). A ka luajtur letërsia e huaj një rol hapës (liberalizues) në atë kontekst?

Padyshim, botimet e huaja dhe letërsia e huaj kanë pasur një ndikim të jashtëzakonshëm emancipues për hapjen e Shqipërisë drejt botës. Edhe në Shqipëri, sinjalet e hapjes deshifroheshin nga botimet e huaja. Preferoheshin shkrimtarët e mëdhenj, dhe sidomos veprat që flisnin kundër diktaturave shtypëse. Mackbethi i Shekspirit ishte jo më kot vepra më popullore e Shekspirit për publikun shqiptar. Po ashtu, nga të gjithë romanet e Gabriel García Márques-it, preferohej «Vjeshta e një Patriarku». Mbaj mend se kur shtëpia botuese Naim Frashëri donte ta botonte këtë roman, andej nga fillimet e viteve '80, kjo shtëpi botuese më kërkoi të shkruaja një *recensë* në favorin e botimit të këtij romani (si rregull, çdo libër që do të botohej duhej të mbështetej nga dy *recensa* të favorshme). Natyrisht, shkrova një recension tepër të favorshëm, duke argumentuar, shpesh edhe në mënyrë manipuluese, përse ky roman duhej të botohej. Ndërkohë Petro Zheji e kishte përkthyer dhe bërë gati romanin për botim. E megjithatë, ky roman nuk u botua, ngase *recensa* e dytë kishte lëshuar alarmin se ky libër ishte i dëmshëm për lexuesit e gjerë! Ironia më e madhe ishte se recensa e dytë, ajo që ishte kundër botimit në shqip të romanit të Márques-it, ishte shkruar nga njëri prej shkrimtarëve tanë më të njohur dhe më progresist. Petro Zheji më tha arsyen. Sipas tij «recensionuesi i dytë ishte kundër botimit të Márques-it në shqip, sepse ai nuk donte që lexuesit të njiheshin me livadhet ku kulloste vetë recensionisti».

Ndërsa përkthimi dhe botimi i librit «Zoti president» i Miguel Ángel Asturias-it qe më me fat. Ky libër, në përkthimin mjeshtëror të Petro Zhejit, pati një popullaritet të jashtëzakonshëm, ngase lexuesit krijonin asosacionin e «Zotit president» me udhëheqësin shqiptar të kohës. Duhet thënë se letërsia hispanoamerikane botohej më lehtësisht se letërsia spanjolle. Kujtoj se që në vitin 1951 ishte përkthyer dhe botuar Jorge Amado « Shqipëria e re », dhe në vazhdim, deri në rënien e komunizmit, me sa di unë, arritën të botohet mbi 40 vepra të letërsisë latinoamerikane, ku shquhen emrat e Pablo Nerudës, Miguel Ángel Asturias-it, ose Gabriel García Márques-it.

Gjatë kohës që kam punuar në gazetën *Drita* kam arritur që të botoj në faqet e kësaj gazete për herë të parë autorë si T.S Eliot, Ezra Pound, Milan Kundera, Franz Kafka, Frederich Nietzsche, F. Scott Fitzegerald (po përmend përkthimet e mia) - dhe sa e sa autorë të tjerë të mëdhenj bashkëkohës. Gjatë kohës së komunizmit, lexuesit më thoshin se në Shqipëri ekzistojnë dy raste kur njerëzit janë të durueshëm për të pritur në radhë - për të blerë bukën dhe për të blerë gazetën *Drita* ditën e diele. Njëra nga arsyet e popullaritetit të gazetës *Drita* ishin padyshim përkthimet nga letërsia e huaj që botohej aty.

1.3. Çfarë funksionesh të tjera keni ushtruar gjatë jetës suaj profesionale, të lidhura me hispanizmin, botën editoriale apo, në përgjithësi, me kulturën? Nëse nuk gabojmë, keni mbajtur detyrën e Drejtorit të Marrëdhënieve të Kulturës në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë dhe keni punuar në Ambasadën e Shqipërisë në Londër («Rudolf», s. f.).

Kam qenë profesor letërsie në gjimnazin e qytetit të Lezhës, pastaj mësues në fshatrat e Lezhës, si dënim, pasi libri im i parë poetik, me titullin «Shokët e mi» u tërhoq nga libraritë «*me*

Esta publicación es resultado del proyecto *Escritores latinoamericanos en los países socialistas europeos durante la Guerra Fría. Fase II* (ELASOC II, PID2023-149252NB-I00) financiado por MICIU/AEI/10.13039/501100011033 y por FEDER, UE.

Proyecto PID2023-149252NB-I00 financiado por:
MINISTERIO DE CIENCIA, INNOVACIÓN Y UNIVERSIDADES
Cofinanciado por la Unión Europea
AGENCIA ESTATAL DE INVESTIGACIÓN

urdhër nga lart», dhe pasi një poezi e imja, ajo me titullin «Lidhjet e mia me natyrën» u kritikua nga vetë Kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve si poezi me ndikime borgjeze dhe dekadente, në një Plenum Partie, në praninë e Enver Hoxhës.

Në vitin 1986 ndoqa kursin një vjeçar pas universitar për *Kritikë letrare* - një lloj kursi i barabartë me *Masterin* shkencor të sotëm -. Pas mbarimit të këtij kursi, në vjeshtën e vitit 1987 u emërova në gazetën *Drita* – gazeta e vetme letrare dhe artistike e vendit, si redaktor për poezinë shqipe dhe atë të përkthyer.

Pas mbylljes së Lidhjes së Shkrimtarëve, në vitin 1990, nga Qeveria teknike e kohës u emërova Drejtor i Marrëdhënieve të Kulturës me Botën e Jashtme, në Ministrinë e Jashtme - (1992-1994). Për fat të keq, Shqipëria aso kohe ende nuk kishte marrëdhënie diplomatikë të gjëra me Spanjën. Me Spanjën ne nuk kishim marrëdhënie të atij niveli, siç kishim jo se jo me Italinë a Francën, por as edhe me Suedinë a Danimarkën a Finlandën. Kam qenë në Stockholm, i ftuar zyrtarisht nga Qeveria Suedeze - mos u gabofsha viti 1992- kur një punonjëse e Institutit Suedez të Kulturës më njoftoi se disa poezi të miat sapo qenë botuar në Spanjë!!!Kolegët spanjollë ia kishin dërguar poezitë e mia në spanjisht, - në boca - koleges suedeze, dhe ajo e lumtur, më dha lajmin e botimit!

1.4. Ndër veprat tuaja të para si shkrimtar përfshihen përmbledhjet poetike *Shokëve të mi* (1974), *Rruga* (1977), *Sërishmi* (1982), *E dashur* (1985), *Udhëtim për në vendin e gjërave që njohim* (1989) («Rudolf», s. f., ExLibris, 2020). Si ka ndikuar letërsia e huaj në krijimtarinë tuaj poetike?

Letërsia e huaj pati një ndikim të madh dhe vendimtar. Veçanërisht letërsia ruse, letërsia në anglisht (ajo angleze dhe ajo amerikane), letërsia franceze, italiane dhe ajo e gjuhës spanjolle. Nga letërsia në gjuhën spanjolle kam lexuar që në vitet e hershme Miguel Cervantes-in, Vicente Blasco Ibăñez-in, Pedro Calderon de la Barca-n, Lope de Vega-n dhe, më vonë, Federico Garcia Lorca-n. Antonio Machado-n e kam lexuar në fundin e viteve ’80, dhe ky autor ka pasur një ndikim jo të vogël në shijen time poetike të atyre viteve.

1.5. Do të dëshironim të njihnim më nga afër punën tuaj si përkthyes i letërsisë nga gjuha angleze (ExLibris, 2020; Shqiptarja.com, 2013). A keni përvojë si përkthyes edhe nga gjuhë të tjera?

Përkthimi i poezisë së huaj në gjuhën shqipe ka qenë një aktivitet me rëndësi shumë të madhe në jetën time. Kisha botuar poezitë e para dhe tregimet e para, shkrime të cilat u pritën shumë mirë nga lexuesit dhe rrethet letrare. Kisha etje të madhe për të njohur letërsinë bashkëkohore botërore. Një punonjëse e Bibliotekës Kombëtare më dha në mirëbesim dy libra poetikë të Evgenij Jevtushenko, me kushtin për t’ia kthyer ditën e nesërme, librat «Nezhnost» dhe «Yabloko». Jevtushenko konsiderohej si një shkrimtar i urryer për regjimin komunist të Tiranës, pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimit Sovjetik, edhe për arsyen si ai kishte shkruar një poemë kundër Tiranës staliniste. Përktheva nga rusishtja mbi tridhjetë poezi të Jevtushenkos, poezi që filluan të qarkullojnë fshehurazi dorë më dorë në rrethet e ngushta të miqve. Nuk kisha shënuar emrin tim si përkthyes, sepse një gjë e tillë ishte me shumë rrezik. Isha në vitin e dytë a të tretë të

Esta publicación es resultado del proyecto *Escritores latinoamericanos en los países socialistas europeos durante la Guerra Fría. Fase II* (ELASOC II, PID2023-149252NB-I00) financiado por MICIU/AEI/10.13039/501100011033 y por FEDER, UE.

Proyecto PID2023-149252NB-I00 financiado por:
MINISTERIO DE CIENCIA, INNOVACIÓN Y UNIVERSIDADES
Cofinanciado por la Unión Europea
AGENCIA ESTATAL DE INVESTIGACIÓN

Universitetit, rreth moshës 20 vjeçare. Pas rusishtes, mësova si autodidakt anglishten. Në vitin 1972 kam përkthyer novelën e James Joyce-it «Të vdekurit» [The Dead], nga përmbledhja me tregime «Dublinasit» [The Dubliners]. Në vitin 1974, poeti Fatos Arapi – që ishte dhe profesori im në Universitet, më dha një Antologji të poezisë së Amerikës Latine, një botim dygjuhësh spanjisht- italisht. Ishte kontakti im i parë me poezinë e shkruar në gjuhën spanjolle (duke përjashtuar njohjen me poezinë e Nicolas Guillen-it, që ishte botuar që herët në shqip.) Antologjia, ashtu si dhe librat e tjerë, mu dha në mirëbesim, dhe për ta mbajtur për një kohë të shkurtër. Kështu u njoha për herë të parë me poezinë e Amerikës Latine. Nga ajo kohë kam përkthyer (nga italishtja, duke lexuar zëlartë në mënyrën time, origjinalin spanjisht, për të kontrolluar ritmin poetik të origjinalit) poezi të César Vallejo-s, Octavio Paz-it, Jorge Luis Borges-it, Vicence Huidobro-s, Nicanor Parra-së, Ernesto Cardinal-it, Alehandra Pizarnik-ut…Nga këto përkthime, arrita të botoja, në revistën *Nëntori* a në gazetën *Drita*, dy a tre poezi të Cesar Vallejo-s.[1] Ishte hera e parë që ky poet botohej në gjuhën shqipe. Poezitë e Vallejo-s më patën pëlqyer shumë, dhe për një kohë të gjatë ky autor ka mbetur ndër poetët e preferuar të mi…

Fletorja me përkthime të poezive nga autorët e Amerikës Latine kanë qarkulluar vite me radhë, duke u rikopjuar në fletore të tjera. Veç dy vite më parë, - 2024 - kur isha kthyer në Tiranë për disa ditë, një poeteshë, mike e imja e hershme, zonja Shpresa Kapisyzi, më tha se do të më bënte një surprizë. Ajo kishte sjellë me vete një fletore të vjetër, ku ishin ende të ruajtura përkthimet e mia në dorëshkrim të poetëve të Amerikës Latine, të bëra në vitin 1974.

Deri në vitin 1982, poezitë dhe krijimet e tjera të përkthyera nga unë kanë qenë përkthime ilegale- një lloj *samizdat-i*, pa qëllimin e botimit, sepse as nuk mund të mendoje t'i dërgoje për botim.

Në vitin 1978 kam botuar përkthimet e para nga anglishtja, poezi të William Butler Yeats, dhe më vonë poezi italiane nga Salvatore Quasimodo dhe Eugenio Montale (në revistën *Nëntori*) …

1.6. Si do t'ua shpjegonit lexuesve jo shqiptarë marrëdhënien që pushteti politik ka pasur me Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë? Cilat kanë qenë marrëdhëniet tuaja me Lidhjen?

Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë natyrisht duhej të plotësonte kriterin stalinist të krijuesit si shërbyes i Partisë. Por pas këtij slogani, marrëdhënia e shkrimtarëve me shtetin komunist ishte shumë më tepër komplekse se kaq. Mendoj se talenti i vërtetë nuk mund të futet kurrë në klishetë e doktrinave ideologjike, qofshin këto të majta a të djathta. Letërsia e vërtetë është jashtë kornizave të -izmave, të vendosura nga censurat e kohërave. Kryesia e Lidhjes së Shkrimtarëve - sidomos autorët e talentuar të saj, si Ismail Kadare a Dritëro Agolli - dukej sikur kishte një pakt të pathënë për të pranuar këtë të vërtetë të heshtur. Nëse një shkrimtar krijonte një vepër me dinjitet artistik dhe të guximshme për kohën, Lidhja e Shkrimtarëve e mbronte nga ndonjë sulm stalinist i kritikëve vigjilentë. Natyrisht, kur sulmet kundër letërsisë së botuar vinin

[1] Midis viteve 1980 dhe 1989 janë identifikuar përkthime të autorëve të mëposhtëm, të realizuara nga Marku dhe të botuara në revistën *Nëntori*: Gabriel García Márquez, César Vallejo (3 tekste), Jorge Luis Borges (2 tekste) dhe Alejandra Pizarnik. Për më shumë informacion, shihni Smajli et al. (2026).

Esta publicación es resultado del proyecto *Escritores latinoamericanos en los países socialistas europeos durante la Guerra Fría. Fase II* (ELASOC II, PID2023-149252NB-I00) financiado por MICIU/AEI/10.13039/501100011033 y por FEDER, UE.

Proyecto PID2023-149252NB-I00 financiado por:
MINISTERIO DE CIENCIA, INNOVACIÓN Y UNIVERSIDADES
Cofinanciado por la Unión Europea
AGENCIA ESTATAL DE INVESTIGACIÓN

nga zyrat e Komitetit Qendror, apo nga Udhëheqja e Partisë Komuniste, Lidhja e Shkrimtarëve përpiqej të gjente rrugë të tjera për t'i mbrojtur autorët e sulmuar.

2. ARDHJA E LIBRIT TË HUAJ NË SHQIPËRINË SOCIALISTE

2.1. Duke iu referuar periudhës komuniste, a mund të paraqisni një panoramë të sistemit botues shqiptar në lidhje me botimin e letërsisë së huaj?

Letërsia e huaj ka qenë e prezantuar me dinjitet gjatë periudhës komuniste. Sidomos gjatë periudhave 1960 - 1972 dhe 1984 -1990. Mendoj se meritën më të madhe për këtë e kanë pasur përkthyesit e asaj periudhe. Përkthyesit qenë disa nga intelektualët më të njohur të shoqërisë shqiptare, shumica e të cilëve kishin studiuar në vendet perëndimore. Të tillë si Vedat Kokona, Gjon Shllaku, Pashko Gjeçi, Lasgush Poradeci, Dhimitër Pasko, Petro Zheji, Sotir Caci, Klio Evangjeli, Robert Zhvarc, Petro Marko. Emrave të tyre iu shtuan një brez tjetër përkthyesish që kishin studiuar në Rusinë komuniste - Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Drago Siliqi, Jorgo Bllaci. Në fillimet e viteve 80' shfaqet një brez tjetër përkthyesish të rinj, tepër të talentuar, të cilën janë të orientuar drejt përkthimit të letërsisë më bashkëkohore, të tillë si Aurel Plasari, Mira Meksi dhe Pirro Misha.

Kryeveprat e letërsisë botërore qenë më me fat, sepse ato u përkthyen nga mjeshtër të ndërgjegjshëm profesionalistë - mund të them si veprat e Homerit, Dante, Shekspiri, Servantesi, Pushkini, Gogoli, Lermontovi, Tolstoj, Heminguej, mund të kenë në gjuhën shqipe ndër përkthimet e tyre më të bukura që mund të gjesh në botë.

2.2. Më pas, pas rënies së komunizmit, vërejmë se shfaqen shtëpi të reja botuese me rëndësi për përhapjen e letërsisë hispanoamerikane. Për shembull, kemi parasysh shtëpinë botuese *Dituria*. A mund të zgjeroni, ju lutem, informacionin mbi këtë aspekt?

... është e vërtetë se pas rënies së komunizmit, numri i veprave të përthyera u shtua në mënyrë të ortek-shme. Por duhet thënë se në krahasim me periudhën e komunizmit, në periudhën pas, përkthimi filloi të motivohej në shumicën e rasteve nga komercializmi. Kjo ka ndodhur dhe me botimet e letërsisë amerikano-latine - ndonëse kjo letërsi është më me fat nga shumë letërsi të tjera, sepse është përkthyer nga mjeshtër të tillë si Aurel Plasari, Mira Meksi, Bajram Karabolli dhe Bashkim Shehu. Ky i fundit ka përkthyer në mënyrën më brilante romanin *Patria* të shkrimtarit spanjoll Fernando Aramburos dhe tre vepra të romancierit kilian Roberto Bolaño.

...Për të bërë një përngjasim të përkthimeve të dy periudhave - para dhe pas komunizmit në Shqipëri - më lejoni të sjell një përvojë timen. Mbaj mend se në vitin 1992 bëra gati përmbledhjen e poezive të T. S. Eliot, E. Pound dhe të W. H. Oden – përkthimi në një libër të vetëm të tre poetëve ndër më të mëdhenjtë të shekullit të XX-të. Asnjë shtëpi botuese nuk pranonte që ta botonte, sepse shtëpitë botuese më thoshin se «nuk kemi interes që të botojmë libra me poezi, sepse këto libra nuk shiten». Shkrimtarët Zija Çela dhe Frederik Reshpja - dy miq të mi të afërm - ma botuan privatisht, me shpenzimet e tyre, duke shënuar kësisoj dhe botimin për herë të parë në gjuhën shqipe të këtyre tre poetëve ndër më të mëdhenjtë e shekullit të kaluar.

Edhe diçka tjetër - përkthyesit e periudhës së komunizmit punonin në kushtet më të vështira, atyre iu mungonin fjalorët e mëdhenj profesionalë, punoni me normë - me sa më kujtohet

Esta publicación es resultado del proyecto *Escritores latinoamericanos en los países socialistas europeos durante la Guerra Fría. Fase II* (ELASOC II, PID2023-149252NB-I00) financiado por MICIU/AEI/10.13039/501100011033 y por FEDER, UE.

Proyecto PID2023-149252NB-I00 financiado por:
MINISTERIO DE CIENCIA, INNOVACIÓN Y UNIVERSIDADES
Cofinanciado por la Unión Europea
AGENCIA ESTATAL DE INVESTIGACIÓN

- norma ishte tetë faqe në ditë pune, pavarësisht nga vepra a nga autori që përkthehej -. Pas komunizmit, përkthyesit janë ata që e kanë mësuar gjuhën e huaj nga përkthejnë në vendet përkatëse dhe i njohin gjuhët e huaja më mirë nga përkthyesit e kohës së komunizmit. Por ka ndodhur paradoksi i madh. Ndonëse përkthyesit e sotëm i njohin më mirë gjuhët nga përkthejnë, kanë fjalorë të mëdhenj dhe më të fundit në dispozicion, kanë kushte ku e ku më të mira, prapë se prapë nuk e arrijnë nivelin e përkthimeve më të arrira të kolegëve para-ardhës, për arsyen e thjeshtë se përkthyesit bashkëkohës të sotëm kanë mësuar gjuhët e huaja nga përkthejnë, duke mos e ditur gjuhën shqipe, në të cilën përkthejnë!

2.3. Sipas bazës së të dhënave që po përgatisim aktualisht mbi librat e letërsisë hispanoamerikane të përkthyera në shqip, midis viteve 1951 (Jorge Amado, *Shqipëria e re*) dhe 1991 (Gabriel García Márquez, *Dashuria*…), janë botuar 46 vepra. Në këtë numërim kemi përfshirë edhe antologjitë, si dhe 7 libra të botuar në Prishtinë (Smajli *et al.*, 2026). Për shembull, në këtë listë përfshihen disa libra të Pablo Nerudës, Miguel Ángel Asturias-it dhe Gabriel García Márques-it.

a. **Si realizohej përzgjedhja e veprave konkrete të letërsisë së huaj (raporte lexuesish, instanca të ndryshme censurimi, ndërmjetësime nga agjentë të ndryshëm kulturorë, marrëdhënie me shtëpi botuese të huaja)?**
b. **Duke pasur parasysh përvojën tuaj në ambasadën shqiptare në Londër («Rudolf», s. f.), a kanë ndihmuar diplomatët në sjelljen e letërsisë së huaj në Shqipëri?**

Mendoj se kontributin më të madh në përzgjedhjen e librave që do të përkthehen (duke përfshirë këtu dhe librat e autorëve hispanoamerikanë) e kanë vetë përkthyesit. Juan Rufo, Roberto Bolaño, Fernando Aramburu janë përkthyer dhe përzgjedhur nga vetë personaliteti i përkthyesit. Po kështu ka ndodhur dhe me përkthimet e Gabriel Gracia Marques, i sjellë në shqip për herë të parë nga Plasari dhe më vonë dhe nga Mira Meksi.

Kurdoherë përzgjedhjet janë çështje individuale e vetë përkthyesve.

Ndërsa pyetjes tuaj të fundit - nëse ndihmojnë diplomatët në futjen e letërsisë së huaj- mund të them se diplomatët tanë bëjnë të kundërtën, ata mund të «ndihmojnë» që kjo letërsi të mos futet në vendin e tyre. Thjesht, sepse nuk kanë asnjë lidhje me letërsinë dhe leximet.

3. PRITJA E LIBRIT TË HUAJ NË SHQIPËRINË SOCIALISTE

3.1. Në këtë bllok të fundit pyetjesh, do të dëshironim të thelloheshim në pritjen e letërsisë së huaj nga lexuesit shqiptarë. Në këtë drejtim, çfarë roli luanin parathëniet në prezantimin e autorëve të huaj për lexuesin shqiptar?

Parathëniet kishin një rëndësi të madhe, sepse shpesh herë lexuesit ballafaqoheshin me autorë të panjohur ose me vepra të panjohura. Ato ishin një *guidë* për t'u orientuar në një botë të panjohur.

Esta publicación es resultado del proyecto *Escritores latinoamericanos en los países socialistas europeos durante la Guerra Fría. Fase II* (ELASOC II, PID2023-149252NB-I00) financiado por MICIU/AEI/10.13039/501100011033 y por FEDER, UE.

Proyecto PID2023-149252NB-I00 financiado por:
MINISTERIO DE CIENCIA, INNOVACIÓN Y UNIVERSIDADES
Cofinanciado por la Unión Europea
AGENCIA ESTATAL DE INVESTIGACIÓN

3.2. Po recensat, kritikat apo studimet e tjera akademike?

Recensionet pozitive për autorët e huaj apo veprat e përkthyera mirëpriteshin me entuziazëm nga lexuesit. Ndërsa për studime akademike as nuk mund te flitet!

3.3. Cilat ishin botimet periodike më të rëndësishme për njohjen e risive në letërsinë e huaj?

Gazeta *Drita* dhe revista *Nëntori* - organe të Lidhjes së Shkrimtarëve.

Esta publicación es resultado del proyecto *Escritores latinoamericanos en los países socialistas europeos durante la Guerra Fría. Fase II* (ELASOC II, PID2023-149252NB-I00) financiado por MICIU/AEI/10.13039/501100011033 y por FEDER, UE.

Proyecto PID2023-149252NB-I00 financiado por:
MINISTERIO DE CIENCIA, INNOVACIÓN Y UNIVERSIDADES
Cofinanciado por la Unión Europea
AGENCIA ESTATAL DE INVESTIGACIÓN

SHTOJCA:
Lista e librave të përkthyer dhe të botuar nga Rudolf Marku

Marku, R. (1991). *Tre poetë amerikanë. "Flaka e Vëllazërimit"*. Skopje: Ministrisë së Kulturës, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Marku, R. (1995) *T. Eliot, E. Paund, U. Oden, Tokë e shkretë*, shqipëruar nga Rudolf Marku. Tiranë: Sh.B. e Lidhjes së Shkrimtarëve.

Marku, R. (2017). *Retë që shkasin atje tej, retë e mrekullueshme. Antologji e poezisë botërore*. Tiranë: UET / Mapo.

Marku, R. (2024). *Safo. Poezi. Botim bilingual greqisht e vjetër-shqip*. Kosovë: Dukagjini.

Marku, R. (2025). *Katuli. Poezi. Botim bilingual latinisht-shqip*. Kosovë: Dukagjini.

Marku, R. (2025). *Poezitë më të bukura të botës. Antologji*. Tiranë: Mediaprint.

Marku, R. (2025). *Kratili*, Platoni. Kosovë: Dukagjini.

Esta publicación es resultado del proyecto *Escritores latinoamericanos en los países socialistas europeos durante la Guerra Fría. Fase II* (ELASOC II, PID2023-149252NB-I00) financiado por MICIU/AEI/10.13039/501100011033 y por FEDER, UE.

Proyecto PID2023-149252NB-I00 financiado por:
MINISTERIO DE CIENCIA, INNOVACIÓN Y UNIVERSIDADES
Cofinanciado por la Unión Europea
AGENCIA ESTATAL DE INVESTIGACIÓN

Referenca

ExLibris. (2020, 31 de octubre). "Kush është Rudolf Marku, i pari Poet Laureat shqiptar?".

ExLibris. (2023, 25 de septiembre). "Rudolf Marku: Nga 'Dorëshkrimet e botuara', 1971-1989".

"Rudolf Marku". s. f. Robert Elsie. Albanian literature. Albanian authors.

Shqiptarja.com. (2013, 29 de agosto). "Rudolf Marku: Si më sulmoi shkrimtari i Komitetit Qendro".

Smajli, Brikena; Gallardo-Saborido, Emilio J.; Osja, Vjollca; Nikjari, Xherardo (2026). (en preparación). "Base de datos sobre la presencia de la literatura hispanoamericana en la prensa y las revistas culturales albanesas durante el socialismo". DIGITAL.CSIC.

Esta publicación es resultado del proyecto *Escritores latinoamericanos en los países socialistas europeos durante la Guerra Fría. Fase II* (ELASOC II, PID2023-149252NB-I00) financiado por MICIU/AEI/10.13039/501100011033 y por FEDER, UE.